

Drejtuar:

- a) Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
- b) Kryetarit të Partisë të të Drejtave të Mohuara

Subjekti: Mos-Pranimi i Angazhimit të Auditimit për Shkak të Mos Pagesës së Tarifave

Të nderuar,

Me cilësinë e Audituesit Ligjor të emëruar me vendim nr. 56 datë 28.6.2024 "Përzgjedhjen e Ekspertëve Kontabël të Licensuar (Auditues Ligjor) për Auditimin e Fondeve të Përfituara dhe të Shpenzuara nga Partitë Politike për Vitin Kalendarik 2023," për realizimin e misionit kemi kryer procedurat e mëposhtme:

Pas nënshkrimit të Kontratës nr. 2230 prot date 27/07/2024 lidhur me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga Partitë politike për vitin kalendarik 2023, dërguam njoftim Subjektit "Partia e të Drejtave të Mohuara", në adresën e përcaktuar në kontratën e auditimit për Subjektin, nëpërmjet shërbimit postar me numër 1060 datë 30/07/2024, ku e vendosim në dijeni Partinë e të Drejtave të Mohuara.

- a) Kontratën e shërbimit me nr. 2230 prot date 27/07/2024;
- b) detyrat e audituesit ligjor në këtë angazhim auditimi;
- c) Kërkohej bërja e mundur për përcaktimin e një dite dhe orari kohor për paraqitjen e audituesit ligjor në selinë e Partisë ku do të diskutojmë objektivat dhe planin e auditimit
- d) Afatet ligjore dhe kontraktuale për mbarimin e misionit auditimit
- e) Kërkohej të dërgohen të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës nga departamenti i financës me të cilin do të bashkëpunojmë gjatë procesit të auditimit, duke përfshirë emrin, mbiemrin, adresën e email-it dhe numrin e telefonit.

Në datë 02/08/2024 nga ana e shërbimit postar njoftohemi për mosdorëzim të postës për arsye mos gjetjes së adresës (bashkëngjitur njoftimi dhe zarfi i kthyer).

Kemi bërë përpjekjet e mëtejshme për gjetjen e Partisë dhe kemi arritur të gjejmë adresën. Kemi komunikuar me Kryetarin e Partisë duke e informuar për detyrimin ligjor që ka për përgatitjen e raportit financiar vjetor dhe kryerjen e auditimit ligjor të këtij raporti financiar vjetor. Kemi komunikuar për tarifën e auditimit të përcaktuar në kontratën e nënshkruar mes audituesit dhe KQZ. Kryetari i Partisë na ka bërë të ditur që nuk do të paguajë për shërbimin e auditimit.

Për rrjedhojë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), në veçanti SNA 210 "Rënia Dakord për Kushtet e Angazhimit të Auditimit", audituesit duhet të vlerësojnë kushtet paraprake për pranimin e një misioni auditimi në përputhje me standardet profesionale. Një faktor kyç për përmbushjen e këtij detyrimi është siguri i kompensimit të drejtë për shërbimet e ofruara.

Fatkeqësisht, meqenëse Partia e të Drejtave të Mohuara nuk është në gjendje të paguajë tarifën e audituesit për auditimin e raportit financiar vjetor 2023, sic përcaktuar në kontratën e auditimit me KQZ, më vjen keq t'ju informoj se nuk mund të pranoj angazhimin në këto kushte.

Sipas udhëzimeve të SNA-ve, kur burimet e duhura, përfshirë kompensimin, nuk ofrohen, auditori duhet të refuzojë angazhimin. Si rrjedhojë, nuk do të jem në gjendje të vazhdoj me auditimin për raportin financiar të vitit 2023 dhe për rrjedhojë të kryej procedura auditimi dhe të shpreh një opinion auditimi.

Iris


Qirjaqi

Qirjaqi
Date: 2024.09.10
14:40:39 +02'00'

Nëse situata ndryshon, ose nëse keni pyetje të mëtejshme lidhur me këtë çështje, jam e gatshme të diskutoj më tej.

Faleminderit për mirëkuptimin tuaj.
Me respekt,

Iris QIRJAQI
Auditues Ligjor


10 Shtator 2024
Tiranë, Shqipëri

KEI Auditing & Consulting
Mobile: +355 689055228
Email: iris.qirjaqi@keiauditing.com
Rruga Skender Luarasi, 1 floor, Tirana, Albania
www.keiauditing.com

Iris
Qirjaqi

Digitally signed by Iris
Qirjaqi
Date: 2024.09.10
14:40:39 +0200



27/28

LAJMËRIM MARRJENR

Yrës Pranuesë të Lajmërimit

Plotësohet nga dërguesi i cili duhet të tregojë drejtimin e tij të plotë për kthimin e këtij lajmërimi Mod P6

Ky lajmërim - marrje do të kthehet në adresën time si më poshtë:

Z. I. N. S. ... R. P. ...
Drejtuesi Luana
Sheshi Gjeneral San Xhaxhi Haxhi
Nd. 3, 116
Tiranë, Shqipëri

0689055228

181

Forma e adresës së dorësuar me kuti për shërbime të shtesë (Kthim, Dërguesi, Adresë, etc.)



M: Pantes e ke Drejtave te Mohuara
Adri: Dr. Xhevdet W Bush, nr. 17
Tiranë, Shqipëri

Nr. 1060
DEFTESE 30/07/2024 19:18:31

PRANIMI E OBJEKTEVE POSTARE

Objekti Letra Leter
KOD-BAR RR642300T66AA
Dërguesi IRIS QIRJAZI
Marresi PARTIA E TE DREJTAVE TE MOHUARA E RE
Vend Mberrija TIRANA
Pesha 30 gr
LM RR640112063AA

Table with 2 columns: Shërbime të vecanta, LM ne postim, Tarifa Shtese, Tarifa Postare, Tarifa Totale, Nenshkrimi. Values: 50, 50, 80, 13, etleva.alik

